

CRNA GORA

Opština Tuzi

Br.Nr:01-031/20-2771

Tuzi- Tuz,13.03.2020. godine

MALI I ZI  
Komuna e Tuzit

**SKUPŠTINA OPŠTINE TUZI**

n/r g-dinu Fadil Kajoshaj – predsjedniku

**PREDMET:** Dostava Predloga Odluka

**NAPOMENA:** Uvrstiti u dnevni red naredne sjednice Skupštine Opštine

**PODNOŠILAC PREDMETA:** Predsjednik Opštine

**OBRAĐIVAČ AKTA:** Sekretarijat za poljoprivredu i ruralni razvoj

**PRILOG:** Predlozi Odluka sa obrazloženjem

Poštovani,

Na osnovu člana 60 stav 2 Statuta opštine Tuzi („Službeni list CG-opštinski propisi“ br.24/19, 05/20) u prilogu Vam dostavljam:

- Predlog Odluke o uslovima, načinu i dinamici raspodjele sredstava Budžeta opštine Tuzi za 2020. godinu namijenjenih za poljoprivredu;
- Predlog Odluke o pristupanju izrade Lokalnog plana zaštite životne sredine opštine Tuzi 2020 -2024 i
- Predlog Odluke o pristupanju izrade Plana upravljanja Spomenika prirode "Kanjon Cijevne" za period 2020-2025, sa izvještajem sa javne rasprave radi stavljanja u proceduru Skupštine opštine Tuzi.

Za predstavnicu predlagača koja će učestvovati u radu Skupštine i njenih radnih tijela prilikom razmatranja ovog materijala određuje se Ismeta Gjoka vd Sekretarka Sekretarijata za poljoprivredu i ruralni razvoj.

**KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT**

Z. Fadil Kajoshaj - Kryetar

**LËNDA:** Dorëzimi i Propozim Vendimeve

**VËREJTJE:** Të përfshihen në rendin e ditës në seancën e rralës së Kuvendit të Komunës

**PARASHTRUESI I PROPOZIMIT:** Kryetari i Komunës

**PËRPUNUESI I AKTIT:** Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural

**SHTOJCË:** Propozimet e vendimeve dhe arsyetimet

I nderuar,

Në bazë të nenit 60 paragrafit 2 të Statutit të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat e komunës” nr. 24/19, 05/20) bashkëngjitur Ju dorëzoj:

- Propozim Vendimin mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2020 të parapara për bujqësi,
- Propozim Vendimin mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtjes së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024 dhe
- Propozim Vendimin për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentit të natyrës “Kanjoni i Cemit” për vitin 2020-2025, së bashku me Raportin nga debati publike për ti hell në procedurën e Kuvendit të komunës së Tuzit.

Për përfaqësuese të propozuesit e cila do të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe trupave punues të tij gjatë shqyrtimit të këtij materiali, përcaktohet Ismeta Gjoka, u.d. së Sekretares së Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural.

S poštovanjem,  
Me respekt,

**PREDSEDNIK – KRYETARI,**  
Nik Jeloshaj  
  
*Nik Jeloshaj*

## PROPOZIM

Në bazë të nenit 38 paragrafit 1 pikës 4 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ" numër 02/18, 34/19), neni 53 paragrafi 1 pika 4 e Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e MZ" numër 24/19, 05/20), si dhe neni 8 Vendimit mbi shpalljen Monument natyror të "Kanionit të Cemit" ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 053/17 prej më 25.12.2017) Kuvendi i Komunës së Tuzit në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_ ka sjellë:

## VENDIM

### **mbi qasjen në hartimin e Planit menaxhues të Monumentit natyror "Kanioni i Cemit" për periudhën 2020-2025**

#### **Neni 1**

I qaset hartimit të Planit të Menaxhimit për Monumentin e natyrës "Kanioni i Cemit" për periudhën 2020-2024 (në tekstin e mëtejme "PMMNKC") Me hartimin PMMNKC do të kontribuohet në avancimin, mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit në territorin e Komunës së Tuzit. Afati i fundit për hartimin e PMMNKC është 12 muaj.

#### **Neni 2("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr.**

Hartimi i PMMNKC do të mbështetet në ligjet vendore dhe ndërkombëtare.

- Ligjit mbi mjedisin jetësor ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 52/16, 073/19, 073/19),
- Ligjit mbi ruajtjen e natyrës ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 054/16, 18/19)
- Ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 064/11, 039/16)
- Planit shtetëror të menaxhimit të mbetjeve në Mal të Zi
- Ligjit mbi ujërat ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr.. 027/07, ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 073/10, 032/11, 047/11, 048/15, 052/16, 055/16, 002/17, 080/17, 084/18)
- Ligjit mbi mbrojtjen e ajrit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 025/10, 040/11,043/15, 073/19)
- Ligjit mbi vlerësimin e ndikimit në ambientin jetësor ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr.. 075/18)
- Ligjit mbi vlerësimin strategjik të ndikimit në ambientin jetësor ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 80/05, 73/10, 40/11, 59/11 dhe 52/16)
- Ligjit mbi mbrojtjen e rrezatimit jonik dhe sigurisë he ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 56/09, 58/09 dhe 40/11, 55/16).
- Ligjit mbi mbrojtjen nga zhurma në ambientin jetësor ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 28/11,01/14 dhe 02/18)
- Ligjit mbi energjetiken ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 05/16 dhe 51/17),
- Vendimit mbi shpalljen e Monumentit natyror "Kanioni i Cemit" dhe rregulloreve të tjera lidhur me këto.

Vendimi mbi regjistrimin ne regjistrin qendror

### **Neni 3**

PMMNKC do ta hartoj ekipi i cili do të jetë i formuar me Aktvendim të posaçëm nga ana e kryetarit të Komunës. Hartimi i PMMNKC do të jetë e hapur për publikun në të gjitha fazat e hartimit.

### **Neni 4**

PMMNKC e miraton Kuvendi i Komunës së Tuzit në periudhën prej katër vitesh.

### **Neni 5**

Mjetet financiare të nevojshme për hartimin e PMMNKC – s do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Tuzit, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe nëpërmes bashkëpunimit me OJQ-t.

### **Neni 6**

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Fletën Zyrtare të MZ – dispozitat komunale”.

Numër: 02-030/20-  
Tuz, \_\_\_\_\_, 2020. god.

**KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT**  
**KRYETARI,**  
**Fadil Kajoshaj**

## ARSYETIM

**BAZA LIGJORE:** Gjendet në nenin 38 paragrafi 1 pika 3 e Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e Mz", nr. 02/18, 34/19), nenin 53 paragrafin e pikën 3 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 24/19), si dhe nenit 8 të Vendimit mbi shpalljen Monument natyror të "Kanionit të Cemit" ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr.053/17 prej më 25.12.2017)

**ARSYET E SJELLJES:** Hartimi i PMMNKC do të mbështetet në ligjet vendore dhe ndërkombëtare. PMMNKC do ta hartoj ekipi i cili do të jetë i formuar me Aktvendim të posaçëm nga ana e kryetarit të Komunës. Hartimi i PMMNKC do të jetë e hapur për publikun në të gjitha fazat e hartimit. PMMNKC e miraton Kuvendi i Komunës së Tuzit në periudhën prej katër vitesh. Mjetet financiare të nevojshme për hartimin e PMMNKC – s do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Tuzit, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe nëpërmes bashkëpunimit me OJQ-t.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Fletën Zyrtare të MZ – dispozitat komunale".

## RAPORT NGA DISKUTIMI PUBLIK I KRYER

**me rast të propozim Vendimin mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjës së mjetëve të Buxhetiti të Komunës së Tuzit për vitin 2020 të parapara për bujqësi: Propozim Vendimi mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtëjës së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024 dhe Propozim Vendimit për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentiti të natyrës “Kanjoni i Cemit” për vitin 2020-2025**

Me Konkludim numër 01-031/20-1888 të datës 20.02.2020, Kryetari i Komunës së Tuzit, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi vetëqeverisje lokale dhe Vendimit mbi pjesëmarrjen e popullatës lokale në kryerjen e punëve publike, ka përcaktuar **Propozim Vendimin mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjës së mjetëve të Buxhetiti të Komunës së Tuzit për vitin 2020 të parapara për bujqësi** kurse me Konkludim numër 01-031/20-1821 të datës 18.02.2020, Kryetari i Komunës së Tuzit ka përcaktuar **Propozim Vendimi mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtëjës së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024 dhe Propozim Vendimit për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentit të natyrës “Kanjoni i Cemit” për vitin 2020-2025**, të cilët janë shpallur në faqen e internetit të komunës së Tuzit [www.tuzi@tuzi.org.me](http://www.tuzi@tuzi.org.me), si dhe janë dorëzuar këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Tuzit dhe organeve lokal të komunës së Tuzit.

**Propozim Vendimin mbi kushtet, mënyrën dhe dinamikën e ndarjës së mjetëve të Buxhetiti të Komunës së Tuzit për vitin 2020 të parapara për bujqësi**, është vënë në diskutim publik në afat prej 15 ditësh, duke filluar nga 20.02.2020 përfundimisht me 05.03.2020.

**Propozim Vendimi mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtëjës së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024 dhe Propozim Vendimit për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentiti të natyrës “Kanjoni i Cemit” për vitin 2020-2025**, është vënë në diskutim publik në afat prej 15 ditësh, duke filluar nga 20.02.2020 përfundimisht me 05.03.2020.

Diskusimin publik në formë elektronike, të shkruar dhe me gojë e ka zhvilluar Komuna e Tuzit. Gjatë diskutimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë u është dhënë mundësia e të shprehurit me shkrim, në formë elektronike dhe me gojë.

Me Program të përcaktuar është organizuar diskutimi publik qendror në lokalet e Kuvendit të Komunës së Tuzit me 27.02.2020, me fillim në ora 10:00, i cili për shkaqe teknike është shtyrë për datën 03.03.2020 në ora 12,00. Në diskutimin publik qendror kanë marrë pjesë 29 pjesëmarrës, nga të cilët 14 i kanë plotësuar fletë-vlerësimin dhe në këtë mënyrë vlerësua diskutimin publik qendror. Diskutimin publik qendror kanë percjellur përfaqësuesit e medieve të akredituar.

Në diskutimin publik qendror, prezent kanë qenë hartueset e akteve Ismeta Gjoka, UD sekretare e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural dhe nëpunesi Robert Camaj, i angazhuari me punë Besnik Gjokiq, të angazhuarit e Sekretariatit për qeverisje lokale Enisa Nikoviq, Nexhmija Paleviq, etj.

Fjalën hyrëse mbi Propozimet e Vendimeve përkatëse ka dhënë Ismeta Gjoka, UD sekretare e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural.

**I. Propozim Vendimi mbi qasjen e përpunimit të Planit lokal të mbrojtëjes së mjedisit të Komunës së Tuzit 2020-2024,** Hartuesja e aktit në diskutimin publik qendror ka prezentua dhe spjegua çfarë përmban vetë akti. Ajo ka treguar se baza ligjore për sjelljen e tij gjendet në nenin 13, 29 dhe 37 të Ligjit mbi mjedisin jetësor ("Fleta Zyrtare e MZ" numër 52/16, 073/19, 073/19) dhe nenit 38 paragrafi 1 pika 3 e Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale ("Fleta Zyrtare e MZ" numër 02/18, 34/19), nenit 53 paragrafit 1 pikës 3 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e MZ" numër 24/19). Kurse lidhur me arsyet për sjelljen në hartim të "PLMM" sipas saj do të kontribuohet në avancimin, mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit në territorin e Komunës së Tuzit. Gjithashtu vuri në dijeni se afati i fundit për hartimin e "PLMM" është 18 muaj. Hartimi i PLMM mbështetet në ligjet vendore dhe ndërkombëtare. PLMM-n do ta hartoj ekipi i cili do të jetë i formuar me Aktvendim të posaçëm nga ana e kryetarit të Komunës. Hartimi i PLMM-s do të jetë e hapur për publikun në të gjitha fazat e hartimit. PLMM-n e miraton Kuvendi i Komunës së Tuzit në periudhën prej katër vitesh. Mjetet financiare të nevojshme për hartimin e PLMM – s do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Tuzit, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe nëpërmes bashkëpunimit me OJQ-t.

**II. Propozim Vendimit për qasjen e punimit të planit të veprimit për administrimin e Monumentit të natyrës "Kanjoni I Cemit" për vitin 2020-2025.** Hartuesja e aktit në diskutimin publik qendror ka prezentua dhe spjegua çfarë përmban vetë akti. Ajo ka treguar se baza ligjore për sjelljen e tij gjendet në nenin 38 paragrafi 1 pika 3 e Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e Mz", nr. 02/18, 34/19), nenin 53 paragrafin e pikës 3 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 24/19), si dhe nenit 8 të Vendimit mbi shpalljen Monument natyror të "Kanionit të Cemit" ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr.053/17 prej më 25.12.2017). Kurse lidhur me arsyet për sjelljen në hartim të PMMNKC mbështetet në ligjet vendore dhe ndërkombëtare. PMMNKC do ta hartoj ekipi i cili do të jetë i formuar me Aktvendim të posaçëm nga ana e kryetarit të Komunës. Hartimi i PMMNKC do të jetë e hapur për publikun në të gjitha fazat e hartimit. PMMNKC e miraton Kuvendi i Komunës së Tuzit në periudhën prej katër vitesh. Mjetet financiare të nevojshme për hartimin e PMMNKC – s do të sigurohen nga Buxheti i Komunës së Tuzit, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe nëpërmes bashkëpunimit me OJQ-t.

**III. Propozim Vendimi mbi shpërndarjen e mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit për vitin 2019 të dedikuara për bujqësinë.** Në lidhje me këtë, hartuesja e aktit, ka dhënë shpjegimin se me Propozimin e Vendimit përcaktohet mënyra e shpërndarjes së mjeteve të Buxhetit të komunës së Tuzit të dedikuara për bujqësinë si Përkrahje e zhvillimit të tregut prodhues të qumshtit, Menaxhimi i rrisqeve në bujqësi, Pjesëmarrje në sigurimin e prodhimit bujqësor, intervenimi në treg, Mbështetje për korrjen e drithërave, prokurimi i pajisjeve dhe makinerisë bujqësore, marketingu i prodhimeve bujqësore, zhvillimi i afarizmit të femrës në bujqësi.

Mbas prezentimit të vendimeve pjesëmarrësve në diskutim publik qendror u është mundësuar që të parashtrorjnë pyetje me gojë dhe me shkrim. Pyetjet në diskutimin publik qendror ka parashtruar Zef Dedvukaj i cili tregoj për nevojën që Lumi urrela poashtu të përkujdeset dhe të kihet kujdes për sa i përket hedhurinave të administrohen ato, sipas tij është e domosdoshme edhe të behet edukimi i bujqëve, gjithashtu foli lidhur me pastrimin e plasmaseve në truëllin bujqësor të cilët ndotin mjedisin jetësor dhe truedhin, trajnimi i tyre imediat.

Ismeta Gjoka i dha përgjigje afirmative dhe tregoj se do të trajtohet kjo çështje.

Pashko Dedvukaj shprehi paknaqësi se nuk janë parë mjete për sa i përket shpënzimeve të domosdoshme për vjeljen e vreshtave dhe se nuk është venë re kjo gjë, si dhe mjetet e parapara për pajisje sipas tij të preorjentohën në vizita në panairë jashtë vendit. Çështje që u cu në dukje nga ai ishte edhe përkujdesja më e madhe që duhet tu jepet kooperativave dhe funksionalizimit të tyre. Në interbvenimin e dyte ai tregoj për nevojën e organizimit të panairëve që kan të bejnë me vreshtari, prodhime nga ky vend

Ismeta Gjoka i dha përgjigje afirmative dhe tregoj se do të trajtohet kjo çështje.

Smail Çunmulaj, prgëzoi për këto mjete të parapara dhe masa të komunës për sa i përket bujqësisë, si dhe foli për rëndësin e kooperativave. Ismeta Gjoka i tregoj se drejt ministris është derguar Vendimi për ndikim në zhvillim të bujqësisë ku janë të parapara të gjitha fushëveprimet dhe pritët pëlqimi nga ana e saj.

Zhelko Miliq tregoj se është krenar që më në fundë në Komunë të Tuzit vjen një shumë e tillë që ndahen për bujqësi dhe ftoj që mjetet të shpërdahen sipas procedurës ligjore pa keqëperdorime. Ai foli se kishte 10ha lakra dhe se nga ministria nuk kishte fituar kurrfar ndihmet.

Lujkoviq Hamdija tregoj se ky buxhet duhet të vazhdoj të rritet e të jetë gjithnjë e më i madh.

Martin Berishaj tregoj se Lumi Cemë nuk trajtohet siç duhet dhe duhet një menaxhim më i mirë i tij.

Debati publik përfundoj në orën 13:00.

Gjatë gjithë periudhës së paraparë për diskutimin publik, në adresën e Komunës së Tuzit, përmes arkivit si dhe përmes email-it nuk ka arritur asnjë propozim i shkruar, vërejtje apo sygjerim në lidhje me Propozimet e Vendimeve të lartpërmendura.